



Prishtinë: 23.06.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1259_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2054_03_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **19.05.2020**.

në seancën e mbajtur më datë **23.06.2020**, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Harxhimi i përbashkët – I.M. nga Ferizaj, me shifër të konsumatorit DFE - 9038339 si e pa bazuar.
- II. SHFUQIZOHET** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2054_03_20** i datës **16.03.2020**.
- III. OBLIGOHET** KESCO që konsumatorit me shifër DFE – 9038339 për periudhën 11/2012 e deri më 10/2013 ta ngarkoj/faturoj duke marrë për bazë shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës 11/2014 – 10/2015 dhe atë prej 159.75 kWh/muaj.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 19.05.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe. Korrigjimi i KESCO i datës 13.03.2015 prej -373.55€ është i saktë dhe i bazuar në prova. KESCO në ankesë ka theksuar se njehsori nr.62267148 ka qenë i kyçur ilegalisht pa lejen e KEDS-it dhe se viti i prodhimit të njehsorit në fjalë është 2012, andaj edhe shpërndarja e shpenzimit prej vitit 2005 e tutje nuk mund të përdoret pasi që viti i prodhimit të njehsorit është 2012. Shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike është nuk është reale pasi bie ndesh me vitin e prodhimit. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2054_03_20 të datës 16.03.2020 për konsumatorin Harxhim i përbashkët – I.M. me shifër DFE - 9038339.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrigjimi i KESCO i datës 13.03.2015 prej -373.55€ është i saktë dhe i bazuar në prova, Bordi i ZRRE-së thekson gjatë analizave të bëra të gjitha shkresave të lëndës konstaton se korrigjimi i KESCO i datës 13.03.2015 prej -373.55€ i cili korrigjim është bërë duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 11/2012 e deri më 10/2013 ka rezultuar se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike mujore për këtë periudhën është 1,358.42 kWh/muaj, e që as për së afërmi nuk përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit pas kësaj periudhe. Për të mbështetur këtë fakt e argumenton edhe rrjedha e shpenzimit të energjisë elektrike e konsumatorit. Për më tepër Bordi i ZRRE thekson se mesatarja



mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit prej periudhës 11/2013 e deri më 12/2019 është 169.49 kWh/muaj, apo nëse analizohet shpenzimi i energjisë elektrike të konsumatorit për periudhën e njëjtë të shpërndarjes së shpenzimit, por të një viti pas 11/2014 – 10/2015 rezulton se mesatarja mujore e kësaj periudhe është 159.75 kWh/muaj. Gjithashtu ZRRE ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike sipas viteve është: 2015 – 127.00 kWh/muaj, 2016 – 98.67 kWh/muaj, 2017 – 123.58 kWh/muaj, 2018 – 116.50 kWh/muaj; 2019 – 174.08 kWh/muaj. Pra nga kjo analizë e shpenzimeve të energjisë elektrike shihet qartë se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike pas shpërndarjes së bërë nga KESCO (korrigjimi i datës 13.03.2015) nuk përputhet as për së afërmi me shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit në asnjë nga periudhat pasuese.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit së KESCO-s se njehsori nr.62267148 ka qenë i kyçur ilegalisht pa lejen e KEDS-it dhe se viti i prodhimit të njehsorit në fjalë është 2012, andaj edhe shpërndarja e shpenzimit prej vitit 2005 e tutje nuk mund të përdoret pasi që viti i prodhimit të njehsorit është 2012, Bordi i ZRRE thekson se bazuar në procesverbalin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr.000974 të datës 04.10.2013, e ku shihet se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.62267148 prej TL=8589 kWh dhe TU=7133 kWh, nënkupton se njehsori elektrik nr.62267148 ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik edhe para këtij procesverbali të pranimit të njehsorit elektrik, por që nuk ka asnjë informatë nga KEDS apo KESCO se ai njehsor a ka qenë i kyçur te ai konsumator me atë gjendje të shpenzimit apo konsumatori ta ketë shpenzuar nga periudha e vitit 2012, apo që ai njehsor ka qenë edhe te ndonjë konsumator tjerë. Për më tepër duhet theksuar se është fakt se nëse viti i prodhimit të njehsori elektrik nr.62267148 është 2012 atëherë edhe shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën nga vitit 2005 e tutje nuk mund të jetë e saktë dhe si e tillë duhet edhe të ndryshohet.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit së KESCO-s se shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike është nuk është reale pasi bie ndesh me vitin e prodhimit, Bordi i ZRRE thekson se sipas procesverbalit të pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr.000974 i datës 04.10.2013 ku potencohet se viti i prodhimit i njehsorit nr.62267148 është viti 2012, dhe kundërshtimit të KESCO ndaj vendimit të DMK rreth shpërndarjes së shpenzimit të energjisë elektrike nuk mund të bëhet prej periudhës 11/2005 – 10/2013, kjo mund të jetë e saktë dhe se një korrigjim i tillë nuk mund të jetë i saktë dhe si i tillë duhet të ndryshohet. Megjithatë Bordi i ZRRE thekson qartë se edhe korrigjimi i KESCO i datës 13.03.2015 prej -373.55€ nuk është i saktë, e kjo për arsye se te rasti i konsumatorit në fjalë duhet të merret parasysh edhe mospërputhja e madhe e shpenzimit të energjisë elektrike mes shpenzimit të energjisë elektrike të korrigjimi të KESCO dhe shpenzimit të energjisë elektrike pas këtij korrigjimi, pasi nuk ka përputhje të shpenzimit të energjisë elektrike mes këtyre dy periudhave, e që në kushte normale po që se korrigjimi i KESCO të ishte i saktë atëherë ajo shpërndarje e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë korrigjimit të KESCO do të duhej të përputhej me periudhën pas kësaj periudhe. Andaj Bordi i ZRRE potencon qartë se edhe kjo mospërputhje e shpenzimit të energjisë elektrike është një dëshmi dhe argument i fuqishëm se edhe korrigjimi i KESCO nuk ka qenë është i saktë dhe si e tillë duhet të ndryshohet.

Bordi i ZRRE thekson se KESCO nuk ka arritur të ofroj ndonjë sqarim se si është e mundur që njehsori elektrik të jetë i montuar duke regjistruar energji elektrike nga viti 2012 dhe të mos evidentohet nga punëtorët e autorizuar nga KEDS, kur dihet se KEDS/KESCO janë të obliguar të bëjnë lexim dhe faturim të rregullt për çdo muaj konform Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe Procedurës për lexim dhe faturim të konsumatorëve tarifor. Gjithashtu këtu duhet të shtohet fakti se kemi të bëjmë me një ndërtesë kolektive dhe se njehsorët elektrik janë të vendosur në ormanin e njehsorëve dhe punëtorët e autorizuar të OSSH - KEDS janë të obliguar të bëjnë lexim dhe faturim të rregullt mujor.



Bordi i ZRRE duke pasur parasysh vendimin e DMK në ZRRE, dhe kundërshtimit të KESCO ndaj vendimit të DMK ku shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike nuk mund të bëhet prej periudhës 11/2005 – 10/2013 e që kjo mund të jetë e saktë pasi që njehsori nr.62267148 është i prodhimit i vitit 2012, si dhe duke pasur parasysh mospërputhjen e shpenzimit të energjisë elektrike mes mesatares së shpenzimit të energjisë elektrike të korigjimi të KESCO dhe shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit pas korigjimit, dhe në mungesë të të dhënave rreth këtij njehsori elektrik konstaton se konsumatori në fjalë duhet të ngarkohet/faturohet për periudhën 11/2012 e deri më 10/2013 por duke marrë për bazë shpenzimin e energjisë elektrike të periudhës 11/2014 – 10/2015 prej 159.75 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se korigjimi i KESCO-s i datës 13.03.2015 prej - 373.55€ është i saktë dhe i drejtë, përveç faktit se njehsori është i prodhim i vitit 2012 dhe se korigjimi apo shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike e përcaktuar në vendimin e DMK në ZRRE nuk është i saktë pasi nuk përputhet me vitin e prodhimit të vitit 2012.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2020 ka analizuar ankesën e KESCO dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr.ZRRE/DMK_V_2054_03_20, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Harxhimi i përbashkët – I.M dhe
- Arkivit të ZRRE-së.